



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 24723 prot.

Shkodër, më 02.12. 2025

VENDIM

Nr. 78, datë 27.11.2025

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË SHKODËR, SË BASHKU ME
DOKUMENTACIONIN TEKNIKO-LIGJOR, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS
FINANCIARE PËR FAMILJEN E BENET UJKËS, BANESA E TË CILIT ËSHTË
DËMTUAR NGA ZJARRI**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; ligjin nr. 68/2017 “Për financat vendore”, i ndryshuar; VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”; VKM nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, i ndryshuar; VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar; VKB nr. 33, datë 29.05.2025 “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 të miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024 ‘Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër’, i ndryshuar”; si dhe dokumentacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Shkodër për akordimin e ndihmës së menjëhershme financiare për familjen e Benet Ujka (5 anëtarë), në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas certifikatës familjare të paraqitur, për dëmtimin e banesës nga zjarri.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko-ligjor, të hartuar nga Bashkia Shkodër, për familjen e Benet Ujka, me vlerën e dëmit nga ana ndërtimore prej 649 767 (gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë dhe dëmet në orendi prej 324

000 (treqind e njëzet e katër mijë) lekë, sipas preventivave të Komisionit të Vlerësimit të Dëmeve pranë Bashkisë Shkodër, për familjen e Benet Ujka.

3. 3. Burimi i financimit të jetë fondi i emergjencave civile, i parashikuar në programin AB141 “Siguria Publike dhe Mbrojtja Civile”, në buxhetin e Bashkisë Shkodër për vitin 2025, të miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025–2027 të Bashkisë Shkodër”, i ndryshuar, konkretisht në programin AB141, Q2 O1 A4 “Përballimi i ndihmave të menjëhershme për familjet me raste fatkeqësie”, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë. Ngarkohet administrata e Bashkisë Shkodër për likuidimin e ndihmës së menjëhershme.
4. 4. Për familjen e Benet Ujka, kompensimi i dëmeve materiale ndërtimore dhe i dëmeve në orëndi e pajisje do të bëhet sipas preventivave të vlerësimit të hartuar nga grupi i verifikimit dhe vlerësimit, në zbatim të nenit 41 të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, pikës 3 të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, dhe pikës 3.1/a të VKM nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”; si dhe VKB nr. 33, datë 29.05.2025 “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025, e miratuar me VKB nr. 76, datë 19.12.2024”, i ndryshuar. Kompensimi të bëhet sipas relacionit bashkëngjitur, në masën 50% të vlerës ndërtimore, në shumën 324 884 (treqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e tetëdhjetë e katër) lekë, dhe në masën 50% të vlerës së orëndive, në shumën 162 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 32 vota

Vota Pro 32

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 02.12.2025

SEKRETARE

Sabina Danaj

